



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT UJOR VJOSË



Nr. 1/6 Prot.

Vlorë, më 14.02.2025

VENDIM

Nr. 01 , datë 10 /02 /2025

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR RINOVIM TË LEJES/AUTORIZIMIT,
LIDHUR ME RINOVIMIN E LEJES NR. SERIE 07 “LEJE PËR
NXJERRJE DHE SHFRYTËZIM TË UJIT NËNTOKËSOR
NËPËRMJET SHPIMIT, PËR QËLLIME TË NDRYSHME”, TË
SUBJEKTIT “DUKA” SH.P.K

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujrave të pëdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Vjosë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovim të lejes/autorizimit, lidhur me rinovimin e lejes Nr.07 “Leje për nxjerrje dhe shfrytëzim të ujit nëntokësor nëpërmjet shpimit, për qëllime të ndryshme”, të subjektit “Duka” Sh.p.k, me vendndodhje: Rruga “Murat Terbac”, Bashkia Vlorë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Koordinatat e vendndodhjes së pus-shpimit:

X= 457233.073 Y= 4478390.822 Z= 2.8 m.m.n.d (KRGJSH)

Sasia e ujit që jepet në përdorim: $Q = 15 \text{ l/s}$

$Q_{\text{mes-vjet}} = 18 \text{ l/s}$

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBU VJOË

PLATOR NESTURI

